



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 8180 prot

Roskovec, më 25.09.2025

PROJEKT-VENDIM

NR ____ . DATË 25.09.2025

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË ROSKOVEC"

Në mbështetje të nenit 8, pika 1; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a"; nenit 23, pika 14, nenit 28 pika 3 dhe 4; nenit 54, shkronja "k", si dhe nenit 64, shkronja "c" të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; të "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 4 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin territorit" (i ndryshuar); Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", indryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.408/2015 "Për miratimin e Rregullores dhe zhvillimit të territorit, i ndryshuar; VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", I ndryshuar; VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", me qëllim shfrytëzimin në mënyrë të unifikuar të hapësirave publike në Bashkinë Roskovec dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit, paraqesim:

Për diskutim dhe miratim

1. Rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave publike në Bashkinë Roskovec, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Në rast miratimi të këtij dokumenti, çdo vendim i mëparshëm i Këshillit të Bashkisë për rregullimin e hapësirave publike që bie ndesh me këtë rregullore, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit Mjedisit Dhe Pronës, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria E Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria E Mbrojtjes Civile.

Konceptoi:

Orgesa Goga

Arben Dukaj

Samuela Plaka

Eldison Kocaqi

Borana Çela

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC

8180/1
Nr. ___ Prot.

Roskovec, me 28.09.2025

RELACION

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE
NË BASHKINË ROSKOVEC"

Në vijim të nevojave dhe problematikave të hasura në rregullimin e kuadrit ligjor mbi hapsirat publike, distancave të lejuara të shfrytëzimit të hapsirave publike, ekspozimit të mallrave jashtë njësisë të tregtimit, shfrytëzimi të hapsirave me vendosjen e mundshme të kioskave, tabelave identifikuese, tabelave reklamuese, reklamave, billBoards, hapësirave reklamuese të dedikuara, hapsirave publike për vendosjen e biçikletave, si dhe kriteret mbi hapësirat e lejuara për parkim, mbi përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë Roskovec, në mbështetje të dispozitave ligjore, parashikimeve të Planit të Pergjithshëm Vendor në fuqi në bashkinë Roskovec vleresojmë se kjo rregullore do realizojë kornizën e duhur tekniko-ligjore për menaxhimin, shfrytëzimin dhe përdorimin e hapësirës publike.

Sa më sipër theksojmë se qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Roskovec, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.

Rregullorja përcakton procedurat për dhënien e përdorimit të hapësirës publike, sipas kategorisë së aktivitetit, kriterëve të lejuara që do të ushtrohet nga subjektet e interesuara dhe pajisjeve, instalacioneve që do të lejohen të përdoren në një hapësirë publike të caktuar.

Në datë 24.09.2025 u zhvillua dëgjesa publike me qytetarët e bashkisë Roskovec për konsultimin e rregullores dhe detyrimeve që lindin gjatë zbatimit të saj.
Në këtë takim pati pjesëmarrje të konsiderueshme nga të gjitha njësitë administrative ku u diskutua dhe u konkludua me dakortësinë e rregullores.

Sipas ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 15 të Vendimit nr. 1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", njësia e vetëqeverisjes vendore në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj për planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit sipas mënyrës së përcaktuar në ligj. Autoriteti vendor përgjegjës mund të miratoj rregulla shtesë për përdorimin e hapësirave publike, sipas nevojave përkatëse.

Në mbështetje të nenit 8, pika 1; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a"; nenit 23, pika 14, nenit 28 pika 3 dhe 4; nenit 54, shkronja "k", si dhe nenit 64, shkronja "c" të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; të "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 4 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin territorit" (i ndryshuar); Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.408/2015 "Për miratimin e Rregullores dhe zhvillimit të territorit, i ndryshuar; VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar; VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 "Për Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", me qëllim shfrytëzimin në mënyrë të unifikuar të hapësirave publike në Bashkinë Roskovec dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit, propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë "Rregulloren për Shfrytëzimin e Hapësirës Publike në Bashkinë Roskovec:

Konceptoi:

Orgesa Goga
Arben Dukaj
Samuela Plaka
Eldison Kocaqi
Borana Çela

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

**RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË
BASHKINË ROSKOVEC**

Baza Ligjore

- Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; I ndryshuar
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji nr. Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore;
- VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar;
- VKM. Nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”;
- VKB “Për miratimin e paketës Fiskale ”.

Përmbajtja

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1- Objekti

Neni 2- Qellimi

Neni 3- Përkufizime

Neni 4- Aktivitetet e lejuara në hapësirat publike

KREU I

DHENIA NE PERDORIM E HAPESIRES PUBLIKE

Neni 5- Rregulla të përgjithshme për dhënien në përdorim të hapësirës publike

Neni 6- Procedura e dhënies në përdorim e hapësirës publike

KREU II

LEJA PER SHFRYTEZIMIN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Neni 7- Procedura dhe afatet për dhënien e lejes së shfrytëzimit të hapësirës publike.

Neni 8- Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

Neni 9- Ndalimet

Neni 10- Mirëmbajtja dhe dëmtimet

Neni 11- Kthimi i hapësirës publike

Neni 12- Detyrimet financiare

KREU III

DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN

Neni 13- Distancat

Neni 14- Hapësira publike/ trotuari me përmasa 200 cm deri në 300 cm

Neni 15- Hapësira publike/trotuari me përmasa nga 300 cm deri në 600 cm

Neni 16- Hapësira publike/ trotuari me përmasa nga 600 cm deri në 900 cm

Neni 17- Hapësira publike me përmasa nga 900 cm ose dhe më shumë

KREU IV

EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

Neni 18- Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

Neni 19- Vendosja e pajisjeve

Neni 20- lënia e lirë e hapësirës publike

Neni 21- Detyrimet e subjektit

KREU V

ZHVILLIMI I PANAIREVE

Neni 22- Leja dhe procedurat e dhënies së saj

Neni 23- Përzgjedhja në bazë të kritereve të përparësisë

Neni 24- Rregulla për zhvillimin e panairit

Neni 25- Rregullat higjieno-sanitare

KREU VI

SHFRYTEZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE

PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, E TË TJERA

Neni 26- Qarkullimi rrugor

Neni 27- Leja dhe procedurat e dhënies së saj

Neni 28- Vendosja e pajisjeve

Neni 29- Subjektet të cilat përjashtohen nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirës publike

Neni 30- Qarkullimi rrugor

KREU VII

ZHVILLIMI I AKTIVITETIT TREGTAR NËPËRMJET VENDOSJES SË STRUKTURAVE PROVIZORE TE SHËRBIMIT NË HAPËSIRAT PUBLIKE

Neni 31- Strukturat provizore të shërbimit

Neni 32- Leja

Neni 33- Procedura e dhënies së lejes për vendosjen e strukturave provizore të shërbimit

Neni 34- Kushtet dhe kriteret që i përmbahen subjektet gjatë ushtrimit të aktivitetit

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35- Sanksionet

Neni 36- Strukturat zbatuese

Neni 37- Hyrja në fuqi

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin e hapësirave publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është shfrytëzimi i hapësirave publike në Bashkinë Roskovec me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik, social, kulturor, turistik dhe krijimin e te ardhurave nga shfrytëzimi i hapësirave publike, si dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të aplikimit të kësaj rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Hapësirë publike”** është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik.
2. **“Shërbimet e lejuara”**, shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, dhe që janë të përputhshme me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit.
3. **“Aktivitete rekreative dhe kulinare”**, përfshihen por pa u kufizuar aktivitete si, baret, restorantet, piceri, fast-food, hoteleri, si dhe çdo shërbim tjetër që ushtrohet në sektorin e shërbimeve sociale.
4. **“Struktura provizore e shërbimit”**, është një strukturë e vogël dhe e përkohshme, në të cilën ushtrohet aktiviteti i tregtimit të përditshëm të suvenireve, kinkalerive, pijeve freskuese, produkteve të duhanit, biletave të autobusit, përfshirë revistat apo gazetatat si edhe sendeve të tjera të këtij lloji.
5. **“Trotuar”**, është zona ndërmjet objekteve dhe karrexhatës që përdoret për aksesin e këmbësorëve. Matet nga fasada e objektit deri në fundin e bordurës së trotuarit.
6. **“Bordura”**, është element i parë që ndan karrexhatën me trotuarin.
7. **“Element Urban”**, është zona në të cilën bëjnë pjesë elemente si pemë në krah të trotuarit, gjelbërim apo shkurre, koshat e plehrave, reklamat, ndriçuesit rrugor, stolat etj.
8. **“Zonë Lëvizëse”**, është hapësira publike që lejon kalimin e këmbësorëve në mënyrë lineare, paralel me karrexhatën dhe pa ndërprerje e cila duhet të jetë e lirë gjithmonë.

9. “**Frontazhi**”, është hapësira publike përpara fasadës së objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik. Pajisjet e përcaktuara më lart duhet të vendosen brenda zonës së frontazhit për të cilën jepet leja.

10. “**Me pajisje**”, kuptohen struktura metalike, plastike ose druri të cilat shërbejnë për ekspozimin e mallit përpara njësisë së tregtimit.

11. “**Panaire të përgjithshëm**”, nënkupton panairët që janë të pa limituar nga karakteristikat e tyre. Këto lloj panairesh mund të organizohen në sektorë të ndryshëm. Në këto panaire ndaloher shitja e armëve, lëndëve eksplozive, fishekzjarreve, objekteve/sendeve me vlerë. 1

2. “**Treg i lëvizshëm**”, kuptohet ajo formë organizimi e tregtisë ambulante në hapësirat publike që kryhet nëpërmjet grupimit të tregtarëve ambulantë në vende të caktuara, një ditë dhe një orë të caktuar, të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre me anë të pajisjeve të çmontueshme (banakë, tezga).13. “Fasadat e pallateve”, janë fasadat e të gjitha objekteve në bashkëpronësi.

Neni 4

Aktivitetet e lejuara në hapësirat publike

1. Kategoritë e aktiviteteve që lejohen të ushtrohen/zhvillohen në hapësirat publike të Bashkisë Roskovec janë:

- a) Ofrimi i shërbimeve rekreative dhe kulinarie,
- b) Zhvillim i aktiviteteve ambulatorë në hapësirat publike;
- c) Ekspozimi i mallrave jashtë njësisë së tregtimit;
- d) Zhvillimi i panairesh;
- e) Zhvillim i aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe manifestimet politike;
- f) Ofrimi i shërbimeve në bar-kafe, ushqime të shpejta, pije freskuese, akullore etj.
- g) Hapësirat reklamuese (City Lights) dhe (Tabelat Reklamuese Led);
- h) Struktura provizore shërbimi.

KREU I

DHENIA NE PERDORIM E HAPESIRES PUBLIKE

Neni 5

Rregulla të përgjithshme për dhënien në përdorim të hapësirës publike

1. Brenda hapësirës publike në territorin e Bashkisë Roskovec lejohet dhënia në përdorim të pasurive shtet, si dhe pasurive në pronësi të Bashkisë Roskovec.
2. Përcaktimi i sipërfaqes së hapësirave publike për përdorim bëhet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës pranë Bashkisë Roskovec, kryesisht ose me kërkesë të veçantë.
3. Afati maksimal i dhenies së hapësirës publike në përdorim është jo më shumë se është 2 vjet.
4. Sipërfaqja maksimale e lejuar e hapësirës publike për dhënie në përdorim sipas kësaj rregullore është jo më shumë se 200 m².
5. Tarifat për hapësirën publike janë të përcaktuara në Paketën Fiskale të Bashkisë Roskovec të miratuar me Vendim Këshilli Bashkiak

6. Ndalohet dhënia në përdorim e hapsirës publike në Parkun e Ri të Qytetit,(bllokun nr.3) , me përjashtim të :

- Zhvillimit të aktiviteteve argëtuese, kulturore dhe manifestimet politike;
- Struktura provizore shërbimi

Neni 6

Procedura e dhënies në përdorim e hapësirës publike

1. Çdo subjekt ka të drejtë të paraqesë kërkesë për marrje në përdorim të hapësirës publike duke paraqitur dokumentacionin e mëposhtem:

- a) *Kërkesën e subjektit për marrje me qira të hapësirës publike;*
- b) *Planin biznesin e hollësishëm, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, si dhe treguesit që do të realizohen;*
- c) *Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB;*
- d) *Vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet*
- e) *shoqërore;*
- f) *Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është i denuar për vepra penale.*
- g) *Vërtetim nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik se subjekti nuk ka detyrime të taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Roskovec.*

2. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës pranë Bashkisë Roskovec plotëson të dhënat për pasurinë që jepet në përdorim sipërfaqja, qëllimi i përdorimit në përputhje me nenin 4 dhe afatin e dhënies në përdorim.

3. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës pranë Bashkisë Roskovec konfirmon nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pronësinë-shtet. Ndërsa për pronat e Bashkisë Roskovec administron dokumentat e pronësise.

4. Për çdo hapësirë publike që planifikohet të jepet në përdorim duhet të hartohet Genplani përkatës dhe të konfirmohet nga drejtuesi i institucionit.

5. Kërkesa e suksesshme kualifikohet në bazë të ofertës me vlerë më të lartë e kombinuar me planin me të përshtatshëm të biznesit.

6. Për qëllim vlerësimit të dokumentacionit të mësipërm ngrihet çdo fillim viti një komision i posaçëm i cili verifikon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet kërkues dhe në rast se është në përputhje me kërkesat e këtij neni e miraton me anë të një vendimi të posaçëm për dhënien e hapësirës publike në përdorim, si dhe në vijim dërgon një kopje të vendimit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës.

7. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës pas miratimit për dhënien e hapësirës publike në përdorim nga Komisioni i Posaçëm dërgon pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik kërkesën për leshimin e fatures për përdorimin e hapësirës publike.

8. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dërgon pranë Drejtorisë së Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës konfirmimin e pagesës së hapësirës publike.

9. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës dërgon pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit.

a. *Kërkesën e miratuar nga titullari i institucionit për lidhjen e kontratës për dhënien e*

hapësires publike ne perdorim,

b. Relacion përmbledhës të miratuar nga Titullari i Institucionit mbi procedurën e ndjekur për miratimin e dhënies e hapësires publike ne perdorim, ku perfshin te dhenat per subjektin kerkues, të dhënat për sipërfaqen e miratuar për dhënien e hapësires në përdorim, afatin e dhënies ne përdorim dhe vlerën përkatëse,

c. Vendimin e miratimit të dhenies se hapësires publike në përdorim ku është pasqyruar edhe subjekti fitues,dhe konfirmimin e pagesës së hapësires publike.

10. Drejtoria Juridike pas administrimit të dokumentacionit sipas pikes 9, të ketij neni harton kontratën për dhënien e hapësires publike në përdorim dhe një kopje e dërgon pranë Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës për ndjekje dhe zbatimin e kontrates.

KREU II

LEJA PER SHFRYTEZIMIN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Neni 7

Procedura dhe afatet për dhënien e lejes së shfrytëzimit të hapësires publike.

1. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij në hapësirat publike për qëllime biznesi si vendosje të tavolinave dhe karrigeve, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, drurë dekorativ, etj të ngjashme me to duhet të pajiset me leje për shfrytëzimin e hapësires publike.
2. Afati maksimal i lejes së shfrytëzimit të hapësirës publike është 2 vite .
Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit përcaktohet në varësi të kategorisë së aktivitetit që subjekti kërkon të ushtrojë, sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore. Për disa kategori të caktuara ushtrimi i aktivitetit në hapësirën publike mund të jetë i kufizuar vetëm në ditë apo në orë të caktuara
3. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën për pajisjen me leje të shfrytëzimit të hapësirës publike të pozicionuar pranë vendit të ushtrimit të aktivitetit duke paraqitur dokumentacionin e mëposhtem:
 - a) Fotokopje të mjetit identifikues;
 - b) Çertifikatën e regjistrimit të subjektit;
 - c) Dokumentacionin për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e hapësires publike, nëse ka;
 - d) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është i denuar për ndonjë veper penale.
 - e) Vërtetimin që subjekti ose personi fizik ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec.
4. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës vlerëson kërkesat e subjekteve duke miratuar ato që janë në përputhje me këtë rregullore.
5. Afati për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve është 15 ditë.

6. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike lëshohet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë shfrytëzimit të hapësirës publike në dokumentat e planifikimit urban pas shlyerjes së detyrimeve perkatese.

Neni 8

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Lejohet vetëm përdorimi i pajisjeve të përcaktuara në lejen për zënie të hapësirës publike.
2. Pajisjet duhet të jenë lehtësisht të çmontueshme dhe nuk duhet të kenë pamje estetike të konsumuar dhe të çrregullt, nuk duhet të bien ndesh me pamjen e përgjithshme, nuk duhet të përmbajne forma denigruese, fyese dhe duhet të miratohen paraprakisht nga struktura perkatese e Bashkisë.

Neni 9

Ndalimet

Ndalohet shfrytëzimi i hapësirës publike në rastet kur:

1. Pengon qarkullimin normal të këmbësorëve dhe automjeteve dhe cenon sigurinë publike, në buzë të trotuarit që korrespondon me vazhdimin e vijave të bardha për lëvizjen e këmbësorëve;
2. Prane vendndalimeve dhe vendqëndrimeve të përcaktuara për mjetet e transportit;
3. Në rastet kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
4. Nuk përmbush normat higjeno-sanitare;
5. Në zona që kufizojnë/pengojnë zhvillimin e aktivitetit tregtar të subjekteve të treta.

Neni 10

Mirëmbajtja dhe dëmtimet

Subjekti, i cili është pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, duhet:

1. Të garantojë një aksesim të hapësirës publike për kalimtarët.
2. Të mirëmbajë pajisjet, të cilat duhet të jenë gjithnjë në rregull dhe të pastra, si dhe të mos mbaje apo të vendos asnjë send tjetër, përveç asaj të miratuar në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike.
3. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i ngarkohet subjektit i cili është i pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike.
4. Dëmi ekonomik, si dëmtim në trotuar, pemë apo hapësirën e gjelbër, vlerësohet nga struktura perkatese të Bashkisë Roskovec në përputhje me aktet ligjore të miratuara për këtë qëllim.

Neni 11

Kthimi i hapësirës publike

1. Hapësira publike duhet të lihet e lirë nga çdo pajisje në rastet kur struktura perkatese të

Bashkisë Roskovec duhet të kryejnë punime në interes të publikut, ose punime mirëmbajtje.

2. Struktura e Bashkisë Roskovec, të paktën 5 ditë para fillimit të punimeve, duhet t'i komunikojë subjektit me shkrim datën në të cilën hapësira duhet jetë e lirë.

3. Hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen e saj të mëparshme në rastet kur:

a) Subjekti nuk është i lejuar të ushtrojë aktivitetin;

b) Mbaron afati i lejes;

c) Shfuqizohet leja/autorizimi.

4. Nëse lirimi i saj nuk bëhet nga vetë subjekti, Policia Bashkiake në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore marrin masa për lirimin e hapësirës publike.

Neni 12

Detyrimet financiare

1. Dhënia e çdo leje për shfrytëzimin e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e tarifës sëpërcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e nivelit të taksave,tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundravajtësve", e cila varion në bazë të zonës në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin e tij dhe sipërfaqen e hapësirës publike të zënë në m2 .

2. Pagesa bëhet në bankat e nivelit të dytë,pranë Postës Shqipatare,në sportelet e Njësive Administrative.

KREU III

DISTANCAT QË DUHET TË RESPEKTOHEN

Neni 13

Distanca

1. Në këtë kre përcaktohen kriteret për mënyrën e vendosjes së paisjeve në hapësirën publike dhe distancat që duhet të respektohen me qëllim ruajtjen e zonave lëvizëse të këmbësorëve dhe unifikimin e përdorimit të tyre. Distanca e paraqitura në vijim aplikohen në të gjitha format e shfrytëzimit të hapësirës publike.

2. Distanca e Frontazhit përcaktohet në raport me dimensionet e hapësirës publike duke garantuar gjithmonë:

a) Zonën Lëvizëse, e cila nuk mund të jetë më pak se 150 cm, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore;


b) Elementin Urban, nëse ka, i cili nuk mund të jetë më pak se 90 cm, dhe;

c) Bordurën, e cila është 15 cm.

Neni 14

Hapësira publike/ trotuari me përmasa 200 cm deri në 300 cm

1. Kur hapësira publike/trotuari është 200 cm deri në 255 cm dhe ka Element Urban, nuk mund të jepet hapësirë publike;
2. Në rast se hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 255 cm por më e vogël se 300 cm, dhe ka Element Urban, Subjektit i lind e drejta të shfrytëzojë diferencën prej 45 cm.
3. Në rast se hapësira publike/trotuari është deri në 200 cm dhe nuk ka Element Urban, atëherë duhet të garantohej një Zonë Lëvizëse për këmbësorët minimalisht me 150 cm dhe subjekti mund të përdorë një hapësirë Frontazhi prej 50 cm.
4. Në këtë rast kur Frontazhi për subjektet është 50 cm dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si psh. karrige, tavolina, saksite etj), nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
5. Në rast se hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 200 cm por më e vogël se 300 cm, dhe nuk ka Element Urban, hapësira mbi 200 cm mund t'i jepet frontazhit. Zona Lëvizëse mbetet 150 cm.




Shembull: Pra nëse hapësira publike/Trotuari është 230 cm dhe nuk ka Element Urban, 150 cm është Zonë Lëvizëse dhe diferenca prej 80 cm mund t'i jepet frontazhit.

Neni 15/a


Hapësira publike/trotuari me përmasa nga 300 cm deri në 600 cm

1. Kur hapësira publike/trotuari është 300 cm, duhet të garantohej një Zonë Lëvizëse për këmbësorët prej 150 cm, me Element Urban prej 90 cm dhe me Bordura prej 15 cm.

2. Në këtë rast kur Frontazhi për subjektet është 45 cm dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si psh. karrige, tavolina, saksitë, etj), atëherë nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
3. Në rast se hapësira publike/trotuari është 300 cm, por mungojnë Elementet Urban, Hapësira mund të ndahet në proporcion ndërmjet Zonës Lëvizëse me 60 % dhe Frontazhit me 40 %.
4. Në rast se hapësira publike/trotuari është më i madh se 300 cm dhe më i vogël se 600 cm, Hapësira mbi 300 cm ndahet në proporcion ndërmjet Zonës Lëvizëse (60%) dhe Frontazhit (40%).



Pra nëse hapësira publike/Trotuari është 350 cm dhe nuk ka Element Urban, 60% e 350 cm është 210 cm e cila i rezervohet Zonës Lëvizëse dhe 40% e 350 cm është 140 cm e cila mund t'i jepet frontazhi



Shembull: Pra nëse hapësira publike/Trotuari është 450 cm dhe ka Element Urban dhe bordurë, diferenca e 300 cm me dimensionin e trotuarit prej 150 cm ndahet 60% 150 cm është 90 cm e cila rezervohet për Zonën Lëvizëse dhe 40% e 150 cm është 60 cm e cila mund t'i jepet frontazhit.

Neni 15/b

Hapësira publike/trotuari me përmasa nga 500 cm deri në 700 cm (Me më shumë se një element urban)

1. Kur hapësira publike/trotuari është 500 -700 cm , duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët prej 200 cm, me Element Urban prej 90 cm dhe me Bordura prej 15 cm.
2. Në këtë rast kur Frontazhi për subjektet është 100-300 cm dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si psh. karrige, tavolina, saksitë, etj), atehere nuk duhet të kalojnë këtë distancë.


Neni 16

Hapësira publike/ trotuari me përmasa nga 600 cm deri në 900 cm


1. Në rast se hapësira publike/trotuari është mbi 600 cm duhet të garantohet një Zonë Lëvizëse për këmbësorët minimalisht prej 300 cm, Elementi Urban prej 90 cm dhe Bordura prej 15 cm.
2. Në këtë rast kur Frontazhi për subjektet është 195 cm dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si psh. karrige, tavolina, saksite etj) atehere nuk duhet të kalojnë këtë distancë.

3. Në rast së hapësira publike/Trotuari është më e madhe se 600 cm por më e vogël se 900 cm, hapësira mbi 600 cm mund të ndahet në proporcion ndërmjet Zonës Lëvizëse me 60 % dhe Frontazhit me 40 %.

4. Në rast së hapësira publike/trotuari është 600 cm, por mungojnë Elementët Urban, Hapësira mund të ndahet në proporcion ndërmjet Zonës Lëvizëse me 60 % dhe Frontazhit me 40 %.



Shembull: Pra, nëse hapësira publike/trotuari është 800 cm dhe ka element urban dhe Bordurë, hapësira prej 800 cm ndahet 60 % per Zonën Lëvizëse dhe 40 % mund t'i jepet Frontazhit.




Shembull: Pra, nëse hapësira publike/trotuari është 800 cm dhe nuk ka element urban, hapësira prej 600 cm ndahet 60% per Zonën Lëvizëse dhe 40 % mund t'i jepet Frontazhit.

Neni 17

Hapësira publike me përmasa nga 900 cm ose dhe më shumë

1. Në sipërfaqet publike me përmasa 900 cm dhe më shumë duhet të garantohet një zonë lëvizëse për këmbësorët prej 500 cm, Elementi Urban prej 90 cm dhe Bordura prej 15 cm.
2. Në këtë rast kur Frontazhi për subjektet është 295 cm maksimumi dhe të gjithë elementët përbërës të tij (si psh. karrige, tavolina, saksitë) atëherë nuk duhet të kalojnë këtë distancë.
3. Në rast se hapësira publike është 900 cm, por mungojnë Elementet Urban, zona lëvizëse mbetet e njëjtë. Hapësira prej 90 cm i jepet Frontazhit.
4. Në rast se hapësira publike është më e madhe se 900 cm, hapësira mbi 900 cm i jepet Zonës Lëvizëse 1. Zona e Frontazhit mbetet e njëjtë.



Shembull: Pra, nëse hapësira publike është 1200 cm dhe ka Element Urban dhe Bordurë, hapësira prej 300 cm (=1200 cm –900 cm) i jepet Zonës Lëvizëse.

KREU IV

EKSPOZIMI I MALLRAVE JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

Neni 18

Leja dhe procedurat e dhënies së lejes

1. Në këtë kre përcaktohen rregullat për mënyrën e ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit dhe pajisjen e tregtarëve me lejen përkatëse.
2. Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij të ekspozimit të mallrave jashtë njësisë së tregtimit duhet që të pajiset me leje të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës
3. Leja do të lëshohet me afat maksimal 2 vite.
4. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Mjet identifikimi
 - b) Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
 - c) Vërtetimin nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore;
5. Afati i shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 19

Vendosja e pajisjeve

1. Për vendosjen e pajisjeve jashtë njësisë së tregtimit, mbahen parasysh këto kritere dhe distanca:
 - a) Pajisjet nuk duhen të jenë të fiksuara, si në tokë ashtu dhe në fasadën e ndërtesës;
 - b) Pajisjet duhet të jenë funksionale, të kenë një paraqitje të mirë estetike dhe të jenë të çmontueshme;
 - c) Për pajisjet me shtrirje horizontale distanca ndërmjet fasadës së ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti dhe pjesës më ekstreme të paisjes që shërben për të ekspozuar mallrat nuk duhet të jetë më e madhe se 1 metër, në cdo rast pa cenuar levizjen e kembesoreve;
 - d) Lartësia e paisjes nga toka nuk duhet të jetë më e lartë se 2 metër;

Neni 20

Lënia e lirë e hapësirës publike

1. Pajisjet do të jenë të vendosura vetëm gjatë orëve të zhvillimit të aktivitetit. në të gjitha rastet kur njësia do të jetë e mbyllur ato detyrimisht duhet të hiqen duke lënë totalisht hapësirën të lirë.

Neni 21

Detyrimet e subjektit

1. Subjekti ka për detyrë të mbajë pastër hapësirën publike në të cilën zhvillon aktivitetin e ekspozimit për të cilin i është lëshuar leja.
2. Subjekti duhet të mirëmbajë pajisjet të cilat i shfrytëzon për të ekspozuar mallrat.
3. Subjekti në asnjë rast nuk duhet të hedhë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.

KREU V

ZHVILLIMI I PANAIREVE

Neni 22

Leja dhe procedurat e dhënies së saj

1. Në këtë pjesë të rregullores përcaktohen rregullat për mënyrën e organizimit/zhvillimit të panairove në hapësirat publike të Bashkisë Roskovec nga subjektet që kanë një eksperiencë në zhvillimin e tyre.
2. Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike për organizimin e një panairi duhet të pajiset me lejen përkatëse nga Bashkia Roskovec.
3. Afati i lejes mund të zgjatet me kërkesë të arsyetuar të subjektit dhe me vendim të strukturës përkatëse që ka miratuar lejen për zhvillimin e panairit.
4. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Bashkisë Roskovec 30 ditë përpara periudhës së parashikuar nga ana e tij për zhvillimin e panairit, duke cilësuar karakteristikat e panairit, dimensionet, tipologjia, sipërfaqja e vendeve të tregtimit, ditët e zhvillimit të aktivitetit dheoraret përkatës.
5. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë tekniko–ligjor.
6. Subjekti aplikues duhet t'i përmbahet disa rregullave për plotësimin e dokumentacionit teknik që kanë të bëjnë me:
 - a) Planvendosjen me vendet e tregtimit e cila duhet të jetë e punuar nga një inxhinier i licencuar dhe duhet të përmbajë:
 - i) Sipërfaqen e zonës në të cilën do të zhvillohet panairi;
 - ii) Sipërfaqen e vendeve të tregtimit;
 - iii) Mënyra se si do të sistemohen subjektet në vendet e tregtimit;
 - iv) Përcaktimi i vendeve për çdo sektor të veçantë merceologjik.
7. Kërkesat konkurruese për të zhvilluar panairë në të njëjtin vend dhe në të njëjtat data do të shqyrtohen nga organet përkatëse dhe përzgjedhja e subjektit do të bëhet në bazë të kritereve të perparësise te percaktuara ne nenin 23 te kesaj rregullore.
8. Afati i shqyrtimit të kërkesës është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.
9. Subjekti, i cili fiton të drejtën e organizimit të panairit/pjesëmarrjes, për të zhvilluar këtë aktivitet duhet t'i përmbahet rigorozisht normave të kësaj rregulloreje për mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të panairove.

10. Në rastet për arsye madhore që kanë për bazë interesat e komunitetit, struktura përkatëse që ka miratuar lejen për zhvillimin e panairit, ndryshon ditën dhe/ose orarin e zhvillimit të panairit me vendim të posaçëm i cili i njoftohet subjekteve minimalisht 15 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.

Neni 23

Përzgjedhja në bazë të kriterëve të përparësisë

1. Në rastin kur disa subjekte kanë aplikuar për të zhvilluar një panair në të njëjtën periudhë kohore, Bashkia Roskovec përzgjedh subjektin duke u bazuar në kriteret e mëposhtme të cilat janë renditur sipas rëndësisë:

- a) Numrin më të madh të organizimit të panaireve të zhvilluara në qytetin e Roskovec apo në qytete të tjera;
- b) Në rastin kur subjektet konkurruese janë tërësisht të barabartë duke u bazuar në kriterin e mësipërm do të merret në konsideratë eksperiencia e subjektit, pra subjekti që ka filluar të ushtrojë aktivitetin e tij më heret;
- c) Në rast të barazisë së plotë do të merret në konsideratë dita e aplikimit të tij, data në të cilën është bërë protokollimi i kërkesës së subjektit pranë Bashkisë Roskovec.

Neni 24

Rregulla për zhvillimin e panairit

1. Oraret e zhvillimit të panaireve përcaktohen për çdo panair në mënyrë të veçantë. Subjektet mund të fillojnë të zënë vendet në panair jo më parë se 60 minuta nga fillimi i zhvillimit të aktivitetit.
2. Aparaturat akustike duhet të kenë një amplifikë të moderuar e cila të mos krijojë probleme si për komunitetin ashtu edhe për subjektet e tjera.
3. Brenda të njëjtit sektor merceologjik dhe duke respektuar normat higjeno-sanitare për sektorin ushqimor, lejohen subjektet në mirëkuptim me njëri-tjetrin të shkëmbejnë vendet midis tyre.

Neni 25

Rregullat higjeno-sanitare

1. Të gjitha subjektet që marrin pjesë në panair janë të detyruar të mbajnë pastër ambientin përreth vendit të tyre të punës. Mbeturinat si dhe çdo mbetje tjetër duhet të depozitohen në vendet e caktuara për këtë qëllim.
2. Tregtimi dhe shpërndarja e ushqimeve dhe e pijeve në panaire duhet t'i përmbahet normave higjeno-sanitare. Të gjithë punonjësit që tregtojnë mallra ushqimore, duhet të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.
3. Produktet ushqimore duhet të vendosen në një lartësi jo më të vogël se 50 cm nga toka.

Neni 26

Qarkullimi rrugor

1. Struktura përkatëse që shqyrton dhënien e lejeve për zhvillimin e panaireve në territorin e Bashkisë Roskovec duhet të njoftojë Policinë Bashkiake/organet kompetente në lidhje me

zhvillimin e aktivitetit dhe oraret në mënyrë që të merren të gjitha masat e nevojshme nga organet kompetente.

2. Në rastin kur për zhvillimin e panairit është e nevojshme bllokimi dhe devijimi i qarkullimit të automjeteve apo nëse do të nevojitet për mbarëvajtjen e aktivitetit, atëherë në lejen për zhvillimin e panairit shënohet edhe bllokimi apo devijimi i qarkullimit. Policia Bashkiake në këtë rast merr të gjitha masat e nevojshme.

KREU VI

SHFRYTEZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, E TË TJERA

Neni 27

Leja dhe procedurat e dhënies së saj

1. Në këtë kre përcaktohen rregullat e dhënies së lejes së shfrytëzimit të hapësirave publike për zhvillimin e aktiviteteve promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare, e të tjera.
2. Subjekti që kërkon të zhvillojë aktivitete promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare, në hapësirat publike të Bashkisë Roskovec duhet të pajiset me lejen përkatëse të lëshuar nga Bashkia Roskovec.
3. Leja për të zhvilluar këto aktivitete është e përkohshme, afati maksimal të cilës është jo më shumë se 1 muaj.
4. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Bashkisë Roskovec të paktën 30 ditë përpara periudhës së parashikuar nga ana e tij për të kryer aktivitetin. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë në lidhje me zhvillimin e aktivitetit promovues, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare, e të tjera.
5. Në rastin e aktiviteteve me përmasa të mëdha që do të konsiderohen ato aktivitete të cilat për zhvillimin normal të tyre kërkojnë një shtrirje të gjerë dhe pjesëmarrësit mund të jenë mbi një mijë persona, subjekti duhet të paraqesë planvendosjen e hartuar nga një ekspert i licencuar, ku detyruesisht të jete e pasqyruar sipërfaqja e kerkuar shfrytëzim si dhe forma e organizimit të aktivitetit.
6. Afati i shqyrtimit të kërkesës është 15 ditë nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 28

Vendosja e pajisjeve

1. Instalimet e pajisjeve për të zhvilluar aktivitetin në hapësirat e lejuara për manifestime të ndryshme si: festivale, zhvillime festash të ndryshme, e të tjera mund të vendosen maksimalisht 1 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.

Neni 29

Subjektet të cilat përjashtohen nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirës publike

Bëjnë përjashtim nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirës publike ato subjekte që kryejnë aktivitetet e mëposhtme:

1. Kur manifestimet organizohen apo financohen nga Bashkia Roskovec ose kur Bashkia Roskovec bashkëpunon me organizimet e aktivitetëve me subjektet e tjera.
2. Kur hapësira publike shfrytëzohet për zhvillimin e manifestimeve politike, humanitare apo fetare të cilat njihen nga legjislacioni shqiptar.
3. Kur hapësira publike shfrytëzohet për zhvillim koncertesh nga grupe muzike të cilat nuk kanë qëllim përfitimi. Kjo është e vlefshme kur hyrja është falas.
4. Subjektet e lartpërmendura duhet t'i cilësojnë këto rrethana në kërkesën e paraqitur pranë Bashkisë Roskovec.

Neni 30

Qarkullimi rrugor

1. Strukturat përkatëse që leshon lejen pranë Bashkisë Roskovec duhet të njoftojë Policinë Bashkiake dhe organet kompetente në lidhje me zhvillimin e aktivitetit dhe oraret për të cilat ai do të zhvillohet, në mënyrë që të merren të gjitha masat e duhura për bllokimin e qarkullimit të automjeteve, nëse do të nevojitet për mbarëvajtjen e aktivitetit.
2. Në rastin kur për zhvillimin e aktivitetëve është e nevojshme bllokimi dhe devijimi i qarkullimit të automjeteve apo nëse do të nevojitet për mbarëvajtjen e aktivitetit, atëherë në lejen për zhvillimin e panairit shënohet edhe bllokimi apo devijimi i qarkullimit dhe Policia Bashkiake në këtë rast merr të gjitha masat e nevojshme.

KREU VII

ZHVILLIMI I AKTIVITETIT TREGTAR NËPËRMJET VENDOSJES SË STRUKTURAVE PROVIZORE TE SHERBIMIT NË HAPËSIRAT PUBLIKE

Neni 31

Strukturat provizore të shërbimit

1. Në këtë kre të rregullores përcaktohen rregullat për pajisjen e subjekteve me leje për zhvillimin e aktivitetit të tyre nëpërmjet vendosjes së strukturave provizore të shërbimit në hapësirat publike të Bashkisë së Roskovec.
2. Me ushtrimin e aktivitetit nëpërmjet vendosjes së strukturave provizore të shërbimit kuptohet tregtimi i përditshëm i suvenireve, kinkalerive, pijeve freskuese, produkteve të duhanit, biletave të autobusit, si edhe sendeve të tjera të këtij lloji.
3. Kur hapësira publike është e pashfrytëzuar dhe nuk ka asnjë lloj infrastrukture, subjektit i lind e drejta të kërkojë shfrytëzimin e hapësirës publike, duke marrë parasysh krijimin e zonës lëvizëse jo më pak se 150 cm për këmbësorët.

4. Strukturat provizore të shërbimit duhet të jenë të parafabrikuara dhe me strukturë të qëndrueshme dhe të çmontueshme, por të cilat në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë hapësirën publike në të cilat vendosen dhe hapësirën përreth saj.
5. Pavarësisht karakteristikave specifike, strukturat provizore të shërbimit duhet të përshtaten dhe të harmonizohen me mobilimin urban të zonës dhe ambientin përreth.
6. Strukturat provizore të shërbimit në asnjë rast nuk mund të jetë më e madhe se 10 m² edhe nëse hapësira publike mund të plotësojë kushtet për një sipërfaqe më të madhe.
7. Hapësirat publike që lejohen për vendosjen e strukturave provizore të shërbimit janë përcaktuar në planvendosjet bashkengjitur kësaj rregullore.

Neni 32

Leja

1. Çdo subjekt që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktivitetit tregtar nëpërmjet vendosjes së strukturave provizore të shërbimit, duhet që më parë të pajiset me lejen përkatëse nga Bashkia Roskovec, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
2. Leja lëshohet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë shfrytëzimit të hapësirës publike në dokumentat e planifikimit të territorit.
3. Leja e lëshuar nga Bashkia e Roskovec është personale/unike dhe e patransferueshme tek çdo person/subjekt tjetër.
4. Për qëllime të interesit publik apo sigurisë dhe shëndetit të njerëzve, lejet janë të revokueshme nga Bashkia Roskovec në çdo moment.
5. Leja ka afat maksimal jo më shumë se 2 Vite.
6. Me kërkesë të vetë subjektit, kjo leje mund të lëshohet edhe për periudha sezonale, por jo më pak se një afat prej 1 muaj.
7. Në rastin kur subjekti pajiset me leje për vendosjen e strukturave provizore të shërbimit, në dokumentin e lejes përcaktohen edhe detyrimet e subjektit.

Neni 33

Procedura e dhenies së lejes për vendosjen e strukturave provizore të shërbimit

1. Çdo subjekt që gëzon zotësi juridike për të vepruar dhe është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me adrese të ushtrimit të aktivitetit brenda territorit të Bashkisë Roskovec, ka të drejtë të aplikojë për t'u pajisur me leje për vendosje të strukturave provizore të shërbimit në përputhje me hapësirat e përcaktuara për shfrytëzim nga Bashkia Roskovec.
2. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë pranë Bashkisë Roskovec, kërkesën për të ushtruar aktivitetin tregtar nëpërmjet vendosjes së strukturave provizore të shërbimit duke bashkengjitur dokumentacionin e mëposhtem:
 - a) Mjet identifikimi
 - b) Plan biznesi;
 - c) Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
 - d) Listepagesa e punonjesve;
 - e) Vërtetimin nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik se subjekti ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Roskovec;
 - f) Planin e rlevimit të hartuar nga një ekspert i licencuar;
 - g) Projektin e plotë, i cili përfshin edhe planin e aksesueshmerisë;

h) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është i denuar për vepra penale.
3. Në vlerësim e aplikimeve të paraqitura nga subjektet, u jepet përparësi sipas renditjes së mëposhtme kriterëve si vijojnë:

a) Punësimi:

- i- Personave me Aftësi të Kufizuar;
- ii- Grate Kryefamiljare;
- iii- Emigranteve të deportuar;

b) Numrit të punonjësve që synohet të punësohen;

c) Datën e paraqitjes të kërkesës;

4. Për qëllim të vlerësimit të dokumentacionit të mesipër ngrihet një komision i posaçëm i cili verifikon dokumentacionin e paraqitur nga subjekti kerkues dhe në rast se është në përputhje me kërkesat e këtij neni dërgon propozimin për dhenien e lejes së shfrytëzimit për hapësirën publike nëpërmjet vendosjes së strukturave provizore të shërbimit pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban.

5. Afati i shqyrtimit të kërkesës është 15 ditë pune nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 34

Kushtet dhe kriteret që i përmbahen subjektet gjatë ushtrimit të aktivitetit

Subjektet që kryejnë aktivitetin e tyre nëpërmjet vendosjes së strukturave provizore të shërbimit në hapësirat publike, duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara si më poshtë:

1. Të mos zënë sipërfaqe më të mëdha se ajo e miratuar në lejen për vendosjen e strukturave provizore të shërbimit.
2. Mallrat duhet të ekspozohen dhe të tregtohen vetëm në ambientet e brendshme të strukturave provizore të shërbimit, me përjashtim të gazetave dhe shtypit të përditshëm që mund të ekspozohen në pajisje ngjitur me strukturave provizore të shërbimit dhe jo të fiksuara në tokë.
3. Pastrimi i brendshëm i strukturave provizore të shërbimit si dhe i hapësirës përreth saj do të kryhet nga subjekti që ushtron aktivitetin.
4. Në asnjë rast nuk duhet të hedhin përtokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojnë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.
5. Shërbimi në strukturave provizore të shërbimit nuk mund të mbyllet për më shumë se 15 ditë pa ndërprerje pa marrë më parë miratimin e Bashkisë Roskovec.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35 Sanksionet

1. Në të gjitha rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje nga subjektet përfitues, të

kushteve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike, në rast se nuk është objekt i Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, ndaj subjektit të interesuar do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë:

- a) Paralajmërim me shkrim/akt konstatimi;
- b) Gjobë;
- c) Pezullim;
- ç) Shfuqizimi i lejes.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, konsiderohen shkelje:

- a) Shfrytëzimi i hapësirave publike pa u pajisur më parë me lejen përkatëse;
- b) Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion për shfrytëzim;
- c) Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë;
- ç) Instalimi i pajisjeve për të cilat nuk ka marrë lejen përkatëse;
- d) Kur mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
- dh) Subjekti prish qetësinë publike;
- e) Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo shfuqizimit të saj;
- ë) Kur shfrytëzimi i hapësirës publike nuk është në përputhje me kriteret që janë përcaktuar në lejen e dhënë;

3. Në rastet kur shkeljet mund të jenë objekt inspektimi nga organet tatimore, mjedisore, apo inspektimet në përputhje me legjislacionin e punës apo ndërtimit, sanksionet do të jenë në përputhje me akte ligjore, nënligjore në fuqi.

4. Për çdo shkelje të konstatuar të lejes apo dëmtim i hapësirës publike do të merret masa e ndëshkimit me gjobë sipas akteve ligjore, nënligjore dhe akteve të miratuara për këtë qëllim nga strukturat përkatëse të Bashkisë Roskovec.

5. Për shkeljet e përsëritura për të cilat është marrë 3 (tre) here sanksioni i vendosjes së gjobes nga struktura perkatese propozohet shfuqizimin e lejes.

6. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës pas marrjes së propozimit për shfuqizimin e lejes merr vendim për shfuqizimin e saj brenda 15 ditëve nga marrja e këtijpropozimi.

7. Në rastet kur ka shfrytëzim abuziv të hapësirës publike i kërkohet subjektit që të marrë masa për lirin e hapësirës publike menjëherë. Nëse subjekti nuk liron hapësirën publike, atëherë inspektorët e Policisë Bashkiake do të lirojnë hapësirën e zënë dhe shpenzimet për këtë i faturohen subjektit.

8. Aktet e kontrollit, të mbajtura gjatë inspektimit, ankimohen nga subjekti i interesuar në përputhje me Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 36 **Strukturat zbatuese**

1. Strukturat e ngarkuara për zbatimin e kësaj rregullore në lidhje me lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike, si dhe mbrojtjen dhe garantimin e përdorimit të hapësirës publike janë:

- a) Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Struktura autorizuar perpercaktimin e hapësirave publike të shfrytëzueshme dhe Struktura që leshon lejet e përcaktuara në këtë rregullore.
- b) Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – Struktura inspektuese në lidhje me shlyerjen e detyrimeve për pagesën e tarifës për shfrytëzimin e hapësirës publike. Për këtë qëllim zbaton sanksionet për shkelje të detyrimeve fiskale vendore në bazë të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- c) Policia Bashkiake – Struktura inspektuese për respektimin e kushteve të përgjithshme të lejeve të dhëna nga Strukturat autorizuese. Për këtë qëllim zbaton sanksionet në bazë të kësaj rregulloreje, dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Policia Bashkiake mbështet gjithashtu
- d) Inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në bazë të nenit 4, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëse do të jetë e nevojshme.

Neni 37 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 10 dite pas miratimit në Keshillin e Bashkisë Roskovec.

Konceptoi:

Orgesa Goga

Arben Dukaj

Samuela Plaka

Eldison Kocaqi

Borana Çela

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Bufi